



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 mars 2015
Nr. ref.:RK785/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI175/14

Parashtrues

Sylejman (Daut) Dibra

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-13-0095-A0001-A0005, të 20 majit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sylejman (Daut) Dibra (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave), AC-I-13-0095-A0001-A0005, të 20 majit 2014, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 maj 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), “[...] kur më është ndërprer marrëdhënja e punës pa kurrëfarë baze ligjore”.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI175/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI175/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 20 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Ankesave dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
8. Më 12 shkurt 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 10 maj 2013, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, për t’u regjistruar në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të 20% nga të ardhurat e privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" nga Prizreni (Aktgjykimi C-II-12-0007-C9). Kolegji i Specializuar konstatoi se parashtruesi i kërkesës, nuk i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi transformimin e të drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi

shoqërore (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13). Parashtruesi parashtrroi ankesë ndaj këtij Aktgjykimi në Kolegjin e Ankesave.

10. Më 20 maj 2014, Kolegji i Ankesave (Aktgjykimi AC-I-13-0095-A0001-A0005) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, të 10 majit 2013. Kolegji i Ankesave konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur prova tjera, të cilat dëshmojnë se ai ishte në listën e pagave në kohën e privatizimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kontrata e punës nuk i është ndërprerë në pajtim me ligjin në fuqi, për shkak se ai kurrë nuk kishte marrë një vendim për ndërprerjen e kontratës së punës, të cilin ai do të mund ta kishte kontestuar në përputhje me ligjin në fuqi. Ai pretendon se ishte i njoftuar vetëm gojarisht se i ishte ndërprerë kontrata e tij e punës.

Pranueshmëria e kërkesës

12. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”.

14. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit; ose [...]”.

15. Aktgjykimi përfundimtar i Kolegjit të Ankesave, AC-I-13-0095-A0001-A00051, ishte nxjerrë më 20 maj 2014 dhe i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 maj 2014, ndërsa parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatë më 9 dhjetor 2014, d.m.th. më shumë se 4 muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave.

16. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 27 mars 2015, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani